



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
VLORE

Nr.Regj.Them 921
Dt.Regj 05.04.2016

Nr.671. Vendimi
Datë 04.05.2016

V E N D I M

“Në emër të Republikës”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

Gjyqtar- Astrit Shema

asistuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 04.05.2016 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 921. Regj.Them, date paraqitje 05.04.2016, që i përket paleve ndergjyqese :

Padites: Mimoza Kolleshi, Person Fizik, me Nipt K34224466I, me Adrese Dushk, Lushnje., e perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne séance prej bashkeshortit te saj z. Defrim Kolleshi.

I Paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim te leshuar prej Drejtorit Rajonal te tatimeve dega Fier z. Albert Malaj, prej jurists se kektij institucioni znj. Ervisa Shabani.

Objekti: Kundershtim i “Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore” nr.24088prot dt.02.12.2015 duke kerkuar anulimin e gjobes ne Shumen 50.000 leke per mos leshim te kuponit tatimor, per periudhen tatimore 2015/11.

Baza Ligjore: Ligji nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, nenet 55, 106-110, 122.2, 122.5, 125.

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme, degjoi ne kerkimet perfundimtare palen paditese ne proces e cila u shpreh : Per pranimin e padisë; perfaqesuesi I pales se paditur kerkoi : :-Rrezimin e padisë; si e analizoi çështjen ne teresine e saj :

V Ë R E N:

Paditësia i është drejtuar gjykatës me anën e padisë së mësipërme duke kërkuar sipas objektit te padise.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata mori ne shqyrtim dhe analizoi fillimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje.

Ne lidhje me kete fakt gjykata ju referua ligjit me nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative “KREUT III te saj (nenit 7,pika b) e saj)/kompetenca lendore/ ne te cilin midis te tjerash citohet se :

Gjykatat administrative jane kompetente per : .”. *Gjykatat administrative janë kompetente për:*
a) *mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik; duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marredheniet civile mes paleve ndergjyqese”, çmoi kryesisht se çeshtja e paraqitur eshte ne juridiksionin lendor te kesaj gjykate.*

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar “Kompetenca funksionale” ne te cilin citohet se :” 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative, arriti ne kunkludimin se kjo çeshtje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me competence tokesore kjo gjykate j’u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012”Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ne te cilin citohet se “1. *Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.*

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çeshtje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

Rrethanat e faktit.

Nga administrimi i provave të ndodhura pran DRT Fier, rezulton se Kerkuesi “MIMOZA KOLLESHI”, person fizik me NIPT K34224466I ,me objekt kryesor te ushtrimit te aktivitetit “BAR-KAFE”, me adrese Lagja “Dushk”, Lushnje, ne daten 13.09.2015 ne kuadrin e aksionit kunder informalitetit i eshte ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier. Date ne te cilen eshte mbajtur Akt Konstatimi me nr.0474932 serial. Ne momentin e kontrollit eshte konstatuar se subjekti “Mimoza Kolleshi”eshte e rregjistruar ne organet tatimore, ka te instaluar paisjen fiskale dhe per shitjet qe kryen nuk leshon kupon tatimor. Bazuar ne konstatimin e sipercituar eshte mbajtur Proces-Verbali i gjobes me nr.serial 0179676 dt.13.09.2015 nepermjet se cilit subjekti penalizohet konform nenit 122/1/b me gjobe ne vleren 50.000 leke.

Aktet administrative Akt Konsatimi dhe Procesverbali i Gjobes jane refuzuar te firmosen nga subjekti dhe ky fakt eshte bere evident ne aktet administrative sipas parshikimeve ligjore. Bazuar Akt Konstatimin me nr. nr.0474932 serial dt.13.09.2015 si dhe ne Procesverbalin e Gjobes me nr.0179676 dt.13.09.2015, inspektorët e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier kane nxjerr aktin administrative “Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore” me nr.26976 prot dt.28.12.2015 per gjoben 50.000 per mosleshim kuponi tatimor per here te pare.

Ky akt i komunikohet tatimpaguesit “Mimoza Kolleshi” me NIPT K34224466I nepermjet sherbimit postar rekomande konform percaktive te nenit 23 te Ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar.

Me Aktin Administrativ Njoftim Vleresimi me nr. 26976 prot dt.28.12.2015, subjekti nuk ka gene dakort dhe per kete arsye e ka ankimuar ne Drejtorine e Apleimit Tatimor prane Drejtorise se pergjithshme te Tatimeve. Drejtoria e Apleimit Tatimor e ka marre ne shqyrtim ankimimin e subjektit “Mimoza Kolleshi” dhe ne perfundim te shqyrtimit te ankimimit ka Vendosuar: “Lenien ne fuqi te aktit

Administrative Njoftim Vleresimi me nr. 26976 prot dt.28.12.2015, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, gjobe per mosleshim kuponi tatimor ne Shumen 50.000 leke dhe rrezimin e ankimimit. Me pas subjekti "Mimoza Kolleshi" i eshte drejtuar gjykates me padi me objekt: "Kundershtim i Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore" nr.24088prot dt.02.12.2015 duke kerkuar anulimin e gjobes ne Shumen 50.000 leke per mos leshim te kuponit tatimor."

Ne rrerthana te mesiperme pala paditese i eshte drejtuar kesaj gjykate me padine object gjykimi Brenda afatit ligjor te parashikuar nga neni 18 i ligjit me nr. 49/20012"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Parashtrimet e pales paditese

Ne nuk jemi dakort me kete gjobe dhe kerkojme qe te anulohet nga Ju me argumentet se : a- Ne nukjemi dakort me Njoftim Vlersimi Per Detyrimet Tatimore me nr.prot. 26976 date 28/12/2015 dhe kerkojme qe te anulohet nga Ju per faktin :

a- Ky Njoftim Vlersimi per Detyrime tatimore eshte i pavleshem si akt administrativ sepse nuk permban informacionin e nevojshem te parashikuar ne nenin 69 pika 2 Ligj Nr. 9920, date 19.5.2008 :-
" c) *geshtjen, per te cilen behet njoftimi dhe periudhen ose periudhat tatimore, qe u referohet njoftimi;*
e) *shpjegimin e arsyes se vleresimit*";- Ky njoftim vlersimi nuk tregon asnje lloj reference per gjoben qe lajmeron qe ne te kemi te mundur te shfrytzojme te drejten tone te ligjshme per ankimim .Nuk flet as per akt kostatimi,as per Proces-verbal Gjobe as per shkeljen e kryer dhe asnje sqarim tjeter te nevojshem....

b- Duke besuar dhe supozuar (sepse ne NVT nuk cilesohet asgje) se gjoba njoftuar neve ne Njoftim Vlersimi Per Detyrimet Tatimore me nr.prot. 26976 date 28/12/2015 buron nga Akt-Kostatimi me nr.serie 0474932 date 13.09.2015, akt ky i mbajtur nga grupi i aksionit kunder informalitetit gjate kontrollit ne biznesin tone ne e kundershtojme kete gjobe dhe kerkojme te shfoqizohet nga Ju duke e konsideruar nje vendim arbitrar te inspektoreve te kontrollit vendim te pa mbeshtetur ne referenca ligjore,duke deformuar realitetin dhe faktet te cilat ne po ua paraqesim Juve ne kete kerkese padi. Inspektoret kane shkruar ne Akt-Kostatimin me nr serie 0474932 se:- "*Subjekti eshte ipaisur mepajsje fiskale me nr BN06000513 dhe nuk leshon kuponin tatimor "* Ne e refuzuam ta firmosim kete akt-kostatim sepse ne kete paragraf inspektoret shtremberuar realitetin. Deri ne momentin qe ishin inspektoret per kontroll rreth ores 1-30 min te dates 13.09.2015 ne kidhim leshuar 36 kupona tatimor .Ne kemi filluar te leshojme kupon tatimor qe ne oren 6 e 36 minuta me date 13.09.2015 (vertetuar kjo me raportin e kases fiskale te kesaj date bashkengjitur kesaj shkrese).

Nuk eshte se inspektoret kane percaktuar ne aktkostatimin e tyre se ne nje moment ata kostatuan nje shitje tonen per nje mall te caktuar te pashoqeraar me kupon tatimor per te cilen ata duhej te identifikonin dhe gjobisnin dhe klientin i cili nuk do ishte paisur me kupon tatimor etj etj sic dhe e kerkon ligji thjesht ata gjykuan se duhej te vinin nje gjobe dhe sajuan kete alibi duke shkruar se ne nuk leshojme kupona tatimor sikur ne te mos ishim paisur me kase fiskale (atehere do te keshte vend ky kostatim) nderkoh qe faktet thone te kunderten..

Kjo qe sqaruam me larte sipas nesh tergon qarte se kostatimi I inspektorve eshte I pabazuar dhe ne kemi vepruar ne perputhje me udhezimet me shkrim te administrates tatimore dhe ne baze te nenit 111 "Denimet administrative" pika 4 te Ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 gjoba e vendosur per kete "shkelje tatimore administrative " mund te hiqet.

Bashkengjitur keni kopje te kuponave tatimor te leshuar per daten 13.09.2015 dhe shkresat e tjera qe kane lidhje me kete ceshtje.
Perfundimisht kerkojme : Pranimin e padise.

Prapesimet e pales se paditur

Nga verifikimi i provave materiale te ndodhura prane Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, rezulton se Aktet Administrative Akt Konstatimi me nr.0474932 serial dt.13.09.2015, Procesverbali i Gjebes me nr.0179676 dt.13.09.2015 si dhe Njoftim Vleresimi me nr. 24088prot dt.02.12.2015 jan tersisht jane ne perezupthej me legjislacioni tatimor ne fuqi dhe conform Kodit te Procedurave Administrative, nenet 106 e ne vijim per vlefshmerine e Akteve administrative dhe nuk ka baze ligjore per kundershtrimin e Njoftim Vleresimi me nr.26060 dt.17.12.2015 duke anuluar gjoben e pershkruar ne te per mosleshim kuponi tatimor. Njoftim Vleresimi nr.24088prot dt.02.12.2015 ka dale ne baze te Akt Konstatimit me nr.0474932 serial dt.13.09.2015 dhe te Procesverbalit te Gjebes me nr.0179676 dt.13.09.2015

Se pari: ne lidhje me pretendimin e subjektit se Akt Administrativ Njoftim Vleresimi me nr. 24088prot dt.02.12.201, nuk permban informacionin e nevojshem te parashikuar ne nenin 69 pika 2 te Ligjit te Procedurave Tatimore, pika ç: dhe per kete arsye duhet te shfuqizohet nuk ka baze ligjore pari ne rastet kur akti administrative eshte me gabime, gabime keto te cilat nuk cenojne thelbin dhe permbajtjen e aktit merren masa per korrigjimin e te metave dhe nuk anulohen si akte: Keshtu ne Kodine Procedurave Administrative percaktohet:

Neni 120 Aktet administrative me pasaktesi dhe gabime te dukshme

“Kur akti eshte i vlefshem, por konstatohet se ai permban pasaktesi ose gabime te dukshme, organi kompetent, me nismen e tij ose me kerkesen e pjesemarrsesve ne proces, ndreq gabimet me karakter material, si dhe pasaktesite e dukshme te aktit, pa prekur permbajtjen e tij. Ndrejta nuk lidhet me ndonje afat.”

Per rastet kur aktet administrative te Administrates Tatimore jane me gabime, ligji i procedurave tatimore parashikon te drejten e tatimpaguesit per te bere vrejte ne lidhje me punen e administrates, keshtu ne UMF nr.24 dt.02.09.2008 “Per Procedurat Tatimore” neni 106.1.11 percaktohet: *“106.1.11 Tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë vërejtje për mënyrën e punës së administratës tatimore dhe të punonjësve të saj. Këto vërejtje dëgjohen nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nga zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në këto raste nuk mund të bëhet ankim administrativ.”*

Se dyti: ne lidhje me pretendimin e subjektit se Akt Konstatimi i dates 13.09.2015 eshte i pabazuar ne ligj nuk qendron.

Keshtu administrate tatimore ka te drejte te kryej verifikime ne vendbiznes per te zbuluar ne kohe shkeljet e ligjit nga tatimpaguesit, e drejt/ detyre e Administrates Tatimore qe buron nga neni nr.80 i ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”

Keshtu akt konstatimi dhe Procesverbali i gjebes i dates 13.09.2015 te mbajtuar ne subjektin “MIMOZA KOLLESHI”, nuk jane mbajtur ne kundershtrim me ligjin pasi ne nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” dhe ne UMF nr.24 dt.02.09.2008 te dale ne zbatim te tij.

Ligji percakton se verifikimi ne vend kryhet ne baze te Urdhrit Ditor te Punes dhe pa njoftim paraprak.

Kushet keto te plotesuara ne rastin konkret, pasi Akt Konstatimit me nr.0474932serial dt.13.09.2015 dhe te Procesverbalit te Gjebes me nr.0179676 dt.13.09.2015 jane mbajtur ne zbatim te Urdherit te Punes me nr.11971 dt.07.09.2015.

Procedure kjo e ralizuar ne rastin e paditesit “MIMOZA KOLLESHI”, Akt Konstaimi dhe Procesverbali i Gjebes te dates 13.09.2015 jane hartuar ne prani te subjektit dhe ne momentin e konstatimit te shkeljes. Fakti qe subjekti ka refuzuar firmen eshte i evidentuar qart ne aktet administrative Akt Konstatim dhe Procesverbalin e Gjebes se dates 13.09.2015 duke e kompletuar praktiken ne perputhje me nenin 14 te ligjit Per Kundravajtjet Administrative”.

Perfundimisht : Kerkojme :Rrezimin e padise se paraqitur nga ana e subjektiti "Mimoza Kolleshi" me NIPT K34224466I si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Ligji i Aplikueshem

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, parashikon se: "*Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*".

Ky parashikim kushtetues është në të njëjtën linjë me neni 6 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore: "*Cdo person ka të drejtë që çështja e tij të degjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e cdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar*".

Për sa më sipër, vendimi objekt shqyrtimi do të trajtohet nga gjykata si cdo akt administrativ. Në nenin 15 te igjit me nr. 49/2012" Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet, se: Te drejten e padise e ka :a)cdo subject,qepretendon se I eshte cenuar nje e drejte apo nje interes I ligjshem nga nje veprim apo mosveprim I organit public;

"Padia, sipas nenit 17 të këtij Ligji mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe se atij i cënohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive..."

-L I G J Nr.9920, Datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" I Ndryshuar.
Neni 54 Kuponi tatimor

"1.Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion."

54.3 Për personat e tatuueshëm, të cilët kryejnë furnizime të shërbimeve të natyrës bar-kafe, restorant, mensa, ku konsumohen pije dhe ushqime, lëshimi i kuponit tatimor duhet të bëhet për çdo porosi të kryer. Me porosi të kryer nuk nënkuptohet porosia nga çdo person, por porosia e kryer për çdo tavolinë. Ndërkohë nëse e njëjta klientelë kryen një porosi të dytë, atëherë me dorëzimin e porosisë ajo pajisjet me kuponin tatimor për porosinë e dytë.

Zgjidhja ligjore

Gjykata ne lidhje me barren e proves , ka per reference nenin 35 te ligjit me nr. 49/2012" Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Barra e proves ne te cilin citohet se : "1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët.”, arrin në konkluzionin se padia duhet pranuar për arsyet si më poshtë vijon:

Nga hetimi gjyqësor i kesaj çështje rezultoi e provuar se : paditesja “MIMOZA KOLLESHI”, person fizik me NIPT K34224466I ,me objekt kryesor të ushtrimit të aktivitetit “BAR-KAFE”, me adrese Lagja “Dushk”, Lushnje, ne datën 13.09.2015 ne kuadrin e aksionit kunder informalitetit i është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Date ne të cilën është mbajtur Akt Konstatimi me nr.0474932 serial. Ne momentin e kontrollit është konstatuar se subjekti “Mimoza Kolleshi” është e rregjistruar ne organet tatimore, ka të instaluar paisjen fiskale dhe për shitjet që kryen nuk leshon kupon tatimor. Bazuar ne konstatimin e sipercituar është mbajtur Proces-Verbali i gjobes me nr.serial 0179676 dt.13.09.2015 nepermjet se cilit subjekti penalizohet konform nenit 122/1/b me gjobe ne vleren 50.000 leke.

Aktet administrative Akt Konsatimi dhe Procesverbali i Gjobes jane refuzuar te firmosen nga subjekti dhe ky fakt është bere evident ne aktet administrative sipas parshikimeve ligjore. Bazuar Akt Konstatimin me nr. nr.0474932 serial dt.13.09.2015 si dhe ne Procesverbalin e Gjobes me nr.0179676 dt.13.09.2015, inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier kane nxjerr aktin administrative “Njoftim Vleresimi për Detyrimet Tatimore” me nr.26976 prot dt.28.12.2015 për gjoben 50.000 për mosleshim kuponi tatimor për here të pare.

Ky akt i komunikohet tatimpaguesit “Mimoza Kolleshi” me NIPT K34224466I nepermjet shërbimit postar rekomande konform percaktive te nenit 23 te Ligjit nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar.

Me Aktin Administrativ Njoftim Vleresimi me nr. 26976 prot dt.28.12.2015, subjekti nuk ka qene dakort dhe për kete arsye e ka ankimuar ne Drejtorine e Apleimit Tatimor prane Drejtorise se pergjithshme te Tatimeve. Drejtoria e Apeimit Tatimor e ka marre ne shqyrtim ankimimin e subjektit “Mimoza Kolleshi” dhe ne perfundim te shqyrtimit te ankimimit ka Vendosuar: “Lenien ne fuqi te aktit administrative Njoftim Vleresimi me nr. 26976 prot dt.28.12.2015, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, gjobe për mosleshim kuponi tatimor ne Shumen 50.000 leke dhe rrezimin e ankimimit. Me pas subjekti “Mimoza Kolleshi” i është drejtuar gjykates me padi me objekt: “Kundershtim i “Njoftim Vleresimi për Detyrimet Tatimore” nr.24088prot dt.02.12.2015 duke kerkuar anulimin e gjobes ne Shumen 50.000 leke për mos leshim te kuponit tatimor.”

Pala e paditur ka pretenduar se administrata tatimore ka ndjekur të gjithë procedurën që parashkon Ligji 9920/2009 “Per Procedurat Tatimore”. Inspektorët kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë paditëse dhe aty kanë konstatuar se kjo shoqëri ka realizuar shitje pa leshuar kuponin tatimor.

Neni 122 Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave

1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

- a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:
- b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000

(pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

Nga hetimi I kesaj çeshtje ne kete process gjyqesor rezultoi e provuar se : Njoftim Vleresimi me nr. 26976 prot dt.28.12.2015, leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe vendimarrja e Drejtorise se Apleimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane rezultojne me probleme ligjore thelbesore dhe proceduriale. Keto organe administrative kanë nxjerrë këto akte administrative me pasoja jo të vogla për paditësin dhe nuk ka dhënë arsyetim bindës apo provë mbështetese.

Referuar process-verbalit te konsttaimit te mbajtuar me ne daten 13.09.2015 ne kuadrin e aksionit kunder informalitetit i eshte ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorise Rajonale Tatimore Fier. Date ne te cilen eshte mbajtur Akt Konstatimi me nr.0474932 serial. Ne momentin e kontrollit eshte konstatuar se subjekti "Mimoza Kolleshi"eshte e rregjistruar ne organet tatimore, ka te instaluar paisjen fiskale dhe per shitjet qe kryen nuk leshon kupon tatimor. Bazuar ne konstatimin e sipercituar eshte mbajtur Proces-Verbali i gjobes me nr.serial 0179676 dt.13.09.2015 nepermjet se cilit subjekti penalizohet konform nenit 122/1/b me gjobe ne vleren 50.000 leke.

Inspektorët e palës së paditur kanë pretenduar se paditesaj nuk ka lëshuar kupona tatimor. Në këtë rast është përpiluar një akt konstatimi dhe më pas është lëshuar Njoftim i Vlerësimit të Detyrimeve Tatimore. Mirëpo pretendime të tilla nuk mund të lihen vetëm në kuadrin e konstatimit por edhe duhet provuar në formë të plotë shkresore. Çështja e mosleshimit te kuponit tatimor është një pretendim që nuk provohet nga pala e paditur.Duhet permendur fakti se ne aktin e perpiluar te konsttaimit nga ana e punonjesve te hetimit tatimor Dega Fier rezulton e pasquaruar fakti se ky subject :

- eshte I rregjistruar ne QKR;
- eshte I pajisur me kase fiskale
- ka te afishuar logon tatimore
- ka fature tatimore me T.V.Sh duke bashkangjitur fotokopjet dhe mbylljen e raportit ditor
- subjekti mban ne rregullt dokumentacionin tatimor

Dhe gjithashtu eshte cituar se nuk leshon kuponin tatimor,nder kohe qe nuk ka te pasqyruar faktin se deri ne momentin e akt-kontrollit prej ketij subjekti ne aktivitetin e ushtruar prej paditesses deri ne oren 13.30 min te dates 13.09.2015 paditesja kish leshuar 36 kupona tatimore dhe faktin se kish filluar te leshoje kupon tatimor qe ne oren 6 e 36 minuta me date 13.09.2015 (vertetuar kjo me raportin e kases fiskale te kesaj date bashkengjitur kesaj shkrese).

Gjithashtu vlen per t'u [permndur fakti edhe mbui baze te proves se sjelle nga perfaqesuesja e pales se paditur mbi baze te kerkeses se bere nga gjykata per te provuar faktin se sa kupona tatimore ishin leshuar prej atij subjekti me date 13.09.2015 ku rezultoi e provuar se ishin leshuar 64 kupona tatimor.

Pra provohet fakti se ky subjekt zbaton legjislacionin tatimor ne lidhje me detyrimin e tij per leshimin e kuponit tatimor per cdo lloj porosie te kryer nga klientet.

Nuk rezultoi e pasqyruar ne aktin e konstatimit se cili person kish kryer porosi ne ate subjekt bar-kafe ne pronesi te paditesit dhe qe te mos jete pajisur me kuponin tatimor,pasi pot e pretendohet e kundërta sikurse ne rastin konkret duhej te identifikohet se cili isht personi I cili u gjjet pa kupon tatimor per sherbimine kryer ndaj tij.

Eshte detyrim ligjor I inspektoreve q eta pasqyronin kete fakt ne process-verbalin e konsttaimit fakt I cili nuk ka ndodhur.

Qe te ndodhemi perpara kektij fakti duhet qe te kryhej nje shitje konkrete kudrejt nje subjekti fizim apo juridik dhe kjo shitje te msoshqerohet me leshimin e kuponit tetimor prej shitesit.Pra pala paditese nuk provon se eshte kryer nje shitje e cila nuk eshte e shoqeruar me kupon tatimor,pasi nese

do të is hi vertete ky fakt duhej të penalizohej edhe bleresi i cili nuk ka kerkuar te pajisej me kuponin tatimor.

Inspektorët e palës së paditur nuk kanë paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Kjo mënyrë konstatimi tejkalon procedurat normale të kontrollit ligjor sipas legjislacionit përkatës. Kjo formë kontrolli shkon drejt abuzimit dhe arbitraritetit. Pala e paditur ka për detyrë të pasqyrojë sakte në process-veral faktin konkret dhe jo atë të eventual/te supozuar se kryhet shitje e pa shoqeruar me kupon tatimor.

Pra, nuk kemi një fakt të ndodhur që të aplikohet kundrejt paditesit shkalja administrative e arubuar ketij subjekti.

Nga të gjitha këto akte shkresore me vlerë të plotë provuese rezulton se paditesja ka dokumentuar në përputhje me legjislacioni përkatës të gjithë aktivitetin e saj. Pala e paditur pa të drejtë dhe pa dhënë asnjë argument bindës i ka konsideruar disa fakte të paplota si të shkelje administrative dhe ka llogaritur një detyrim financiar të padrejtë ndaj paditeses.

Inspektorët pa u informuar në mënyrë të plotë dhe përfundimtare kanë vendosur për të gjobitur palën paditëse. Pretendimet e palës së paditur në lidhje me kuponat tatimor nuk janë provuar në asnjë moment gjatë procesit gjyqësor. Nga akti i konstatimit rezultojnë pasaktësi të dukshme. Nuk vërtetohet në asnjë moment nëse shoqëria paditëse ka kryer shitje dhe këto shitje kryhen apo jo me kupona tatimor. Pavarësisht shënimeve përkatëse të inspektorëve në aktin e konstatimit, në këtë akt nuk janë hedhur në mënyrë të plotë dhe korrekte shkeljet e mundshme të gjetura tek shoqëria paditëse. Vetëm shënimi se nuk janë lëshuar kupona tatimor nuk përbën shkelje apriori. Cdo kundravajtje administrative duhet të evidentohet dhe të provohet në menyre të plote.

Gjykata cmon se aktet administrative objekt gjykimi vijnë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligj duke i bërë këto në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative si dhe të Ligjit për Kundravajtjet administrative. Gjykata anulon këto akte administrative, konkretisht Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe anulimin e aktit administrativ Vendimit të Drejtorisë dhe Apelitit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Arsyetimi i këtyre akteve nuk i përgjigjet në vendimarrje rrethanave konkrete dhe për rrjedhojë arsyetimi i tyre nuk është në përputhje me legjislacionin tatimor.

Vlen për t'u theksuar fakti se në njoftim-vlerësim për detyrimet me nr.26976, date 28.12.2015 nuk rezulton i pasqyruar fare fakti se përse është vendosur kjo gjobe, por vetëm theksohet fakti se duhet pagur një gjobe në masën 50.000 leke.

Ne kuptim të nenit 108 dhe 109 të K.Pr. Administrative edhe vendimarrja e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë nuk kanë pasqyruar sakte dhe qartë shpjegimin e rrethanave të faktit dhe t'i jepeshin arsyetimet ligjore në lidhje me pretendimet e paditeses, por vetëm kanë bërë referencë ligjore pa u korrigjuar me rrethanat e faktit dhe në këtë kuptim përdoerimi në arsyetim I të dhenave të paqarta, kontradiktore dhe të pasakta e çon aktin në barazvlefshmeri me mungesën e arsyetimit.

Sa me sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e paditeses është mbështetur në ligj dhe në prova dhe, si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje të plotë, ajo duhet pranuar.

Vlen të theksohet se ku vendim në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.49/2012 « Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative » nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

...

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

Rezulton se në rastin konkret masa e denimit administrativ kundrejt paditeit ka qenë në masën 200 mijë leke dhe për rrjedhojë ndaj këtij vendimi nuk mund të kryhet ankimi.

PER KETO ARSYE :

Gjykata, bazuar ne nenin 126 dhe 310 te K.Pr.Civile dhe nenet 40, 42 te ligjit me nr.49/2012 nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative":

VENDOSI:

-Pranimin e padise.

- Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ njoftim vleresimi tatimor me nr. 24088 prot date 02.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier per masen e gjobes prej 50.000(Pesedhete mije) leke dhene ndaj subjektit person fizik Mimoza Kolleshi me Nipt K34224466I.

Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.

Ky vendim ne reference te nenit 45/ç te ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" është i formës se prere.

U Shpall, ne Vlore sot me date 04.05.2016

SEKRETARE

Anil Rista



GJYQTARI

Astrit Shema



SHPENZIMET GJYQESORE

Takse padie 3.000 leke

Njoftim 200 leke

Shuma totale 3200 leke

